Raporti i Kampionatit të Kosovës në Gjimnastikë Artistike

Data: 20 qershor 2026
Vendi: Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit, Prishtinë
Organizator: Federata e Gjimnastikës e Kosovës
Mbështetës: Ministria e Sportit dhe Rinisë, Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit, Kompania Liri, Alkaline Water, MarEvents, Ice Power dhe Alickaj Print.

1. Përshkrimi

Më 20 qershor 2026, Federata e Gjimnastikës e Kosovës organizoi Kampionatin e Kosovës në Gjimnastikën Artistike, garën më të rëndësishme vendore në kalendarin vjetor të Federatës. Kampionati u zhvillua sipas planit të punës dhe direktivave të garës, me pjesëmarrjen e gjimnasteve nga klubet e Kosovës, si dhe me pjesëmarrjen e sportisteve nga Federata Shqiptare e Gjimnastikës.
Garat u zhvilluan në disiplinat e parterit, traut dhe kapërcimeve, në kategori të ndryshme sipas grupmoshave, ndërsa u shpallën fituesit në shumëgarësh dhe në ekipore. Salla e garës në fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit u rregullua një ditë para garës nga organizatorët e garës nga FGJK dhe nga punëtorët e angazhuar. Shumica e paisjeve u bartën nga Pallati i Rinisë dhe Sporteve.

Numri i gjimnasteve të regjistruara në garë:

	Ardhmëria	Elita	Fushë Kosova	Omnisport	Skenderaj	Halil Alidema Gjilan	Vushtrria	Tomori	Federata Shqiptare
Yllka 2018	1	1	1	0	0	0	0	0	1
Yllka 2017	0	2	2	2	0	0	1	0	2
Para-pioniere 2016 - 2015	0	0	3	1	2	0	0	1	2
Pioniere 2014 - 2013	2	0	2	4	0	0	3	0	2
Juniore 2012 - 2011	1	2	3	0	0	0	2	0	1
Seniore 2010 +	2	4	0	0	0	1	0	2	0
Totali:	6	9	11	7	2	1	6	3	8

Yllka 2018	4 garuese
Yllka 2017	9 garuese
Para-pioniere 2016 - 2015	9 garuese
Pioniere 2014 - 2013	13 garuese
Juniore 2012 - 2011	11 garuese
Seniore 2010 +	7 garuese
***Totali: 53** garuese (WAG)*	

Orari i planifikuar i garës:

Kategoria	Nxemja gjenerale	Nxemja në parter	Fillimi i garës
Juniore & Seniore	09:15 – 09:30	09:30 – 09:55	10:00
Para-pioniere & Pioniere	10:30 – 10:45	10:45 – 11:00	11:00
Yllka	11:30 – 11:45	11:45 – 12:00	12:00

Për shkak të numrit të paraqitjeve dhe ritmit të garës, aktiviteti zgjati më shumë se sa ishte planifikuar fillimisht dhe përfundoi rreth orës 17:00.

2. Ecuria e garës

Gara filloj zyrtarisht nga ora 10:00, ndërsa nxemjet e gjimnasteve të kategorive të para filluan më herët, nga ora 09:15. Fillimisht garuan kategoritë seniore dhe juniore, të cilat zhvilluan nxehjen e përgjithshme në sallën e vogël, më pas nxemjet në veglën e parterit dhe vazhduan me garën. Pas përfundimit të paraqitjeve në parter, ato liruan hapësirën për kategoritë tjera. Me të njëjtën procedurë vazhduan kategoritë pioniere dhe para-pioniere, ndërsa në fund garuan kategoritë yllka.
Pas përfundimit të garave në parter, aktiviteti vazhdoi në disiplinat e traut dhe kapërcimeve, ku gara u zhvillua në tri rotacione. Në secilën rotacion, një grup garonte në kapërcime, një grup në tra, ndërsa grupi i tretë ishte në pushim, duke u përgatitur për rotacionin pasues.

Rotacioni i parë: seniorët dhe juniorët garuan në kapërcime, pionierët dhe para-pionierët në tra, ndërsa kategoritë yllka ishin në pushim.
Rotacioni i dytë: kategoritë yllka garuan në kapërcime, seniorët dhe juniorët në tra, ndërsa pionierët dhe para-pionierët pushuan.
Rotacioni i tretë: pionierët dhe para-pionierët garuan në kapërcime, kategoritë yllka në tra, ndërsa seniorët dhe juniorët ishin në pushim.
Para fillimit të secilës rotacion, gjimnastet kishin në dispozicion 10 minuta nxehje në veglën përkatëse, sipas planit të punës. Ky sistem mundësoi zhvillimin e njëkohshëm të garave në dy disiplina.
Prezent në garë ishte edhe kryqi i kuq i Kosovës të cilët intervenuan disa here gjatë garës, por fatmirësisht nuk kishte ndonjë lëndim të madh në garë.

3. Gjyqtaria

Vlerësimi i ushtrimeve u realizua nga gjyqtarët e Federatës së Gjimnastikës së Kosovës. Dy ditë para garës, me 18 qershor, gjyqtarët kishin takim pune ku u përsëriten informatat kryesore të gjqytarisë si përgatitje para kampionatit.
Kategoritë juniore dhe seniore garuan sipas rregullave të kodit të poentimit, ndërsa kategoritë e vogla kishin disa modifikime që ju lehtësuan pjesëmarjen.
Rregullat e garave u janë dërguar klubeve më herët dhe kishin kohë të mjaftueshme ti lexojnë dhe ti përgatisin gjimnastet.

Gjyqtarët në parter: Abeliana Bregu, Arlind Shaqiri, Ard Kryeziu dhe Amir Tahiraga
Gjyqtarët në tra: Doruntinë Ibrahimi, Abeliana Bregu dhe Arlind Shaqiri
Gjyqtarët në kapërcime: Ard Kryeziu, Lisa Zeqiri dhe Amir Tahiraga

4. Përfundimi

Kampionati i Kosovës në Gjimnastikën Artistike 2026 u përmbyll me sukses, dhe u vrejt një rritje të vazhdueshme të cilësisë së garave vendore nga aspekti organizativ. Këtë vit u ndërmorën disa përmirësime organizative që i dhanë garës një pamje më profesionale. Tavolinat zyrtare u pajisën me mbështjellës, në sallë u vendosën flamujt e Republikës së Kosovës, Republikës së Shqipërisë, World Gymnastics dhe Komitetit Olimpik të Kosovës dhe gjithashtu, të gjithë trajnerët, gjyqtarët, stafi organizativ dhe zyrtarët e garës u pajisën me badge identifikues sipas rolit të tyre. Tavolinat zyrtare të gjyqtarëve ishin të pajisura edhe me flamuj sinjalizues të gjelbër dhe të kuq, të cilët u përdorën gjatë garës.

Federata e Gjimnastikës e Kosovës falënderon të gjitha klubet pjesëmarrëse, trajnerët, gjyqtarët, stafin organizativ dhe partnerët për kontributin e tyre në realizimin e suksesshëm të Kampionatit të Kosovës 2026.

Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTICS FEDERATION

Disa foto nga gara:













FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTICS FEDERATION





Rezultatet e garës mund të gjenden në linkun:

https://fgjk-kos.com/garat-vendore/

Data e raportit: 30.06.2026
Prishtinë